

LA COSTITUZIONE
DELLA REPUBBLICA
ITALIANA

KUSHTETUTA E
REPUBLIKES ITALIANE

Paraqitja

Paraqitja e një botimi të Tekstit të kushtetutës drejtuar qytetarëve të huaj rezident në qytetin tonë, gjashtëdhjet vjet pas zgjedhjes së Asamblesë Kushtetuese, është rasti për të reflektuar mbi aktualitetin e ideve dhe principeve në të dhe rrënjët e thella që e lidhin me qëllimet themelore të bashkëjetesës sonë qytetare e demokratike.

Në të vënit në qendër vlerën e pamungueshme e të pacënueshme të individit njerëzor, Kushtetuta i njeh dhe i respekton dinjitet shoqëror e barazi para ligjit pa dallim gjinije, gjuhe, feje, opinionesh politike, statusi personal e shoqëror.

Pozicioni juridik i të huajit është i mbrojtur nga nenet e Kushtetutës italiane nëpërmjet parashikimit të një rezerve të përforcuar ligji, dhe për këtë ligjvënësit i duhet medoemos t'i përmbahet sa është vendosur nga rregullat e përgjithshme dhe traktatet ndërkombëtare të nënshkruara nga Italia.

Disponueshmëria për mirëpranim në bashkësinë shoqërore e të drejtave të të gjithë atyre që e shohin veten brenda bashkësisë të detyrimeve dhe obligimeve qytetare, pa asnjë diskriminim përkundrajt atyre që mund të na duken të ndryshëm, përfaqëson njohjen e

vlerësimin e pluralizmit të opinioneve, të respektimit të dinjitetit njerëzor e të mbrojtjes së të drejtave si garanci e të mirave e gjërave që nuk janë vetëm individuale, por që i përkasin interesit të të gjithë kolektivitetit.

Pacënueshmëria e të drejtave njerëzore pra, e kuptuar si karakterizim i të drejtave të secilit individ. Një limit, cak absolut, i pabraktisshëm e i pandryshueshëm rrënjësisht për vet Shtetin duke qenë kështu edhe një kufi i sigurt ndaj çdo rishikimi kushtetues të disfavorshëm – nga një mazhorancë e thjeshtë e rastësore parlamentare – i të drejtave njerëzore e të individit. Garanci që mund ti përshtrihet formacioneve shoqërore me të cilat qytetari (nënshtetasi) ka të siguar lirinë më të gjerë të mundur në të marrit pjesë në shoqata, fondacione, sindikata, në të formuarit e ideve e opinioneve e në të treguarit haptas ato, në të shprehurit e identitetit të vet edhe nëpërmjet opinioneve kritike e të të qenit ndryshe nga shumica e/o kultura dominante e çastit.

Dhe në njohjen e diversitetit midis interesave ekonomike, grupeve shoqërore e orientimeve ideale (politike) ka dhe njohje reciproke midis etnive, feve, kulturave e traditave politike të ndryshme sipas principit të pluralizmit e tolerancës që mund të veproje e të bëhet efektiv vetëm në një kontekst bashkëzistence e bashkëjetese në mënyrë paqësore.

Kushtetuta italiane nuk e aprovon luftën ndër mënyrat e të zgjidhurit të konfliktualiteteve. Kjo do të thotë t'i mirëbesosh diplomacisë, dialogimit midis shteteve të ndryshme, autoritetshmërisë të organizatave ndërkombëtare (si psh. OKB-ONU) - të cilave Italia mund ti lëshojë edhe një pjesë të sovranitetit të saj – zgjidhjen e kundërshtive e konflikteve.

Sot vizioni i Etërve të Kushtetutës italiane ka diçka për të mësuar jo vetëm italianëve por edhe qytetarëve të të gjithë botës. Lloji njerëzor në tërësi e tij ka përpara emergjenca serioze: varfëria, pabarazia ekonomike e politike, paqja, ndotja e mjedisit. Nëse mendojmë ti zgjidhim vetëm do të

ndërmerrnim një rrugë të gabuar sepse zgjidhjet tona do të përjashtonin të tjerët. Por, nëse i shikojmë së bashku që ti zgjidhim ato do të gjejmë më tepër arsye që na bashkojnë sesa që na ndajnë: në emër të lirive më të mëdha e të dinjtetit të personit njerëzor, që ishte dje dhe është sot emëruesi më i vogël i përbashkët i kulturave politike e besimeve fetare që ekzistojnë në botë dhe që përfaqësojnë thesarin e vlerave dhe aspiratave kulturore e shpirtërore.

Vlerave dhe principeve që gjejmë në Titullin I të Kartës Kushtetuese ju është besuar respekti dhe mbrojtja e të drejtave të qytetarëve të huaj rezident në vendin tonë.

Ndaj të njëjtave principe e vlera qyteti jonë ndjehet i lidhur nga një traditë dhe histori shekullore në të cilën mikpritja, prirja për dialog e integrim kanë qenë gjithmonë së bashku me respektimin e kulturave, feve, etnive të ndryshme.

Leonardo Domenici
Kryebashkiak i Firences

Hyrja

Duke u nisur nga eksperiencia e Këshillit Territorial për Imigrimin të Provincës e të Prefekturës të Alessandrias që kishin përgatitur për shtyp Kushtetutën në gjuhën ruse, shqipe, franceze, spanjolle dhe arabe në kuadrin e projektit të propozuar nga *Associazione di Volontariato Laboratorio per il Dialogo tra le Culture di Tortona*, Administrata Bashkiake, falë ndihmës dhe bashkëpunimit të tyre ka mundur të kryejë e të përfundojë këtë iniciativë. Në marrëveshje me Këshillin territorial për Imigrimin të Firences kemi vendosur të përkthejme tekstin e Kushtetutës, edhe në gjuhët angleze, filipine, kineze për faktin se këto gjuhë në territorin fiorentin janë mjaft të përdorura.

Si *Assessor all'Accoglienza e Integrazione* mu duk e vendit t'ju sjell përpara këtë punë sepse gjatë këtyre muajve kam njohur mjaft realitete të huaja dhe mendova se përveç familjeve italiane do të ishte e arsyeshme t'ju jepnim dhe familjeve me prejardhje të

huaj një kopje të Kartës tonë themelore si informim mbi të drejtat dhe detyrimet e qytetarëve për t'ju kuptuar më mirë vlerat.

Edhe pse kanë kaluar shumë vjet nga aprovimi konfirmon, në modernitetin dhe aktualitetin e saj, themelin mbi të cilin populli duhet të bazojë jetën e tij qytetare.

Dëshiroj t'i bëj një falenderim Provincës dhe Prefekturës të Alessandrias e Presidentit e Kordinatorit të *Associazione di Volontariato Laboratorio per il Dialogo tra le Culture di*

Tortona sepse puna është zhvilluar nga qytetarë të huaj falas duke mundësuar këtë realizim.

Lucia de Siervo

Assessore all'Accoglienza e Integrazione

KUSHTETUTA E REPUBLIKES ITALIANE

PARIME THEMELORE

Neni 1

Italia eshte nje Republike demokratike, e bazuar ne punen.

Sovraniteti i perket popullit, qe e ushtron ate ne format dhe brenda kufijve te Kushtetutes.

Neni 2

Republika njeh dhe garanton te drejtat e padhuneshme te njeriut, qofte si individ, qofte ne formacionet shoqerore ku zhvillohet personaliteti i tij, dhe kerkon kryerjen e detyrave te domosdoshme te solidaritetit politik, ekonomik e shoqeror.

Neni 3

Te gjitha shtetasit kane dinjitet shoqeror te njejte dhe jane te barabarte perpara ligjit, pa dallim seksi, race, gjuhe, feje, mendimi politik, kushtesh vetjake e shoqerore.

Eshte detyre e Republikes hequja e pengesave te karakterit ekonomik e shoqeror, te cilat, duke kufizuar ne praktike lirine dhe barazine e shtetasve, ndalojne zhvillimin e plote te personalitetit njerezor dhe pjesemarrjen efektive te te gjitha punonjesve ne organizimin politik, ekonomik e shoqeror te Vendit.

Neni 4

Republika u nje dhe e pandare, njeh dhe zhvillon autonomine lokale; kryen, ne sherbimet qe varen nga shteti, dedecentralizimin administrativ me te gjere; i pershtat parimet dhe metodat e legjislacionit te saj me kerkesat e

autonomise dhe te decentralizimit.

Neni 5

Republika, është një dhe e pandarë, njeh dhe nxit autonomitë vendore: realizon në shërbimet, që varen nga Shteti, një shpërqendrim të gjerë administrativ; përshtat parimet dhe metodat e legjislacionit të saj me kërkesat e autonomisë dhe të shpërqendrimit.

Neni 6

Republika kujdeset me norma te posacme per minoritetet gjuesore.

Neni 7

Shteti dhe Kisha katolike, jane, secili ne fushen e vet, te pavarur dhe sovrane. Marredheniet e tyre rregullohen nga Paktet e Lateranos. Ndryshimet e Pakteve, te pranuar nga te dy palet, nuk kerkojne procedure rishikimi te Kushtetutes.

Neni 8

Te gjitha besimet fetare jane njesoj te barabarta perpara ligjit.

Besimet fetare, te ndryshme nga ai katolik, kane te drejte te organizohen sipas statuteve te veta, per aq sa keto nuk vijne ne kundërshtim me rendin juridik italian.

Marredheniet e tyre me shtetin rregullohen me ligj mbi bazen e marreveshjeve me perfeqesite perkatese.

Neni 9

Republika nxit zhvillimin e kultures dhe kerkimin shkencor e teknik.

Ajo kujdeset per mjedisin dhe pasurite historike e artistike te Kombit.

Neni 10

Rendi juridik italian u pershtatet normave te se drejtes nderkombetare pergjithesisht te pranuar. Gjendja juridike e shtetasit te huaj rregullohet me ligj, ne pajtim me normat dhe traktatet nderkombetare.

Shtetasi i huaj, te cilit ne vendin e vet i ndalohej ushtrimi efektiv i lirive demokratike te garantuara nga Kushtetuta italiane, ka te drejte strehimi ne territorin e Republikes, sipas kushteve te percekтуara me ligj. Nuk lejohet ekstradimi i shtetasit te huaj per vepra penale politike.

Neni 11

Italia e hedh poshte luften si instrument cenimi te lirise se popujve te tjere dhe si mjet zgjidhjeje te mosmareveshjeve nderkombetare, pranon, ne kushte barazie me shtetet e tjera, kufuzime te sovranitetit per aq sa jane te nevojshme per nje rend qe te siguroje paqen dhe drejtesine ndermjet Kombeve; ajo incurajon dhe favorizon organizatat nderkombetare qe kane kete qellim.

Neni 12

Flamuri i Republikes eshte tringiyresci italian: i gjelber, i bardhe dhe i kuq, me tre shirita vertikale me permasa te barabarta. Pjesa e pare.

Te drejtat dhe detyrat e shtetasve

Kreu I

Marredheniet Civile

Neni 13

Liria vetjake nuk mund te dhunohet. Nuk lejohet asnje forme burgosjeje, inspektimi ose kontrolli vetjak, dhe as ndonje kufizim tjetër i cfaredoshem i lirise vetjake, pervecse me nje akt te arsyetuar te autoritetit gjyqesor dhe vetem ne rastet dhe menytrat e parashikuara me ligj. Ne raste te jashtezakonshme domosdoshmerie dhe urgjence, te permendura shprehimisht ne ligj, autoriteti i sigurimit publik

mund te marre masa te perkohshme, te te cilat brenda 48 oreve duhet t'i njoftohen autoritetit giyqesor dhe, ne rast se ky nuk i sanksionon brenda 48 oreve pasardhese, quhen te shfuqizuara dhe mbeten pa efekt.

Ndeshkohet cdo dhune fizike ose morale ndaj atyre personave qe sidocofte u nenshtrohen kufizimeve te lirise.

Me ligj caktohen kufijte maksimale te paraburgimit.

Neni 14

Banesa nuk mund te dunohet.

Ne te nuk mund te kryhen kontrole ose bastisje a sekuestrime, pervecse ne rastet dhe menytrat e percaktuara me ligj, sipas garancive te parashikuara per aresye shendetesore dhe te sigurimit publik ose per qellime ekonomike e fiskale rregullohen me ligje te posacme.

Neni 15

Liria dhe fshehtesia e korrespondences dhe e cdo forme tjeter komunikimi nuk mund te dhunohen.

Kufizimi i tyre mund te behet vetem me nje akt te autoritetit giyqesor me garancite e percaktuara me ligj.

Neni 16

Cdo shtetas mund televize e te qendroje lirisht ne cdo pjese te territorit kombetar, me perjashtim te kufizimeve qe ligji cakton ne perjithesi per shkaqe shendetesore ose sigurimi. Asnje kufizim nuk mund te vihet duke u nisur nga arsye politike.

Cdo shtetas eshte i lire te dale nga territori i Republikes dhe te kthehet ne te, pervecse kur ka detyrime ligjore.

Neni 17

Shtetasit kane te drejte te tubohen paqesisht dhe pa arme.

Per tubimet, edhe ne nje vend te hapur per publikun, nuk kerkohet njoftim paraprak.

Per tubime ne vende publike duhen njoftuar paraprakisht autoritetet, te cilat mund t'i ndalojne vetem per shkaqe te vertetueshme sigurimi ose paprekshmerie publike.

Neni 18

Shtetasit kane te drejte te organizohen lirisht, pa autorizim, per qellime qe nuk u ndalohen individeve nga ligji penal.

Ndalohen shoqatat e fshehta dhe ato qe ndjekin, qofte edhe terthorazi, synime politike nepermjet organizimeve te natiresh ushtarake.

Neni 19

Te gjitha kane te drejte te manifestojne lirisht besimin e vet fetar ne cfaredo forme, individuale ose kolektive, ta propagandojne ate dhe te ushtrojne kultin perkates privatisht a

publikisht, me kusht qe te mos jene rite ne kundershtrim ne moralin shoqeror.

Neni 20

Karakterit kishtar dhe qellimi fetar ose i kultit i nje shoqate a institucioni nuk mund te jene shkak per kufizime te posacme legjislative, por dhe as per barra te posacme fiskale formirnin aftesine juridike dhe cdo forme te veprimtarise se saj.

Neni 21

Te gjitha kane te drejte te shprehin lirisht mendimin e vet me fjale, me shkrim dhe me cdo mjet tjeter perhapjeje.

Shtypi nuk mund t'u nenshtrohet autorizimeve ose censurave.

Mund te kryhet sekuestrim vetem ne nje akt te aresyetuar te autoritetit gijqesor ne rast krimesh, per te cilat ligji per shtypin e autorizon ate shprehimisht, ose ne rastin

e shkeljes se normave qe vete ligji parashikon per percaktimin e pergjegjesve.

Ne raste te tilla, kur ka urgjence te domosdoshme dhe nuk eshte e mundur nderhyrja ne kohe e autoritetit giyqesor, sekuestrimi i shtypit periodik mund te kryhet nga oficere te policise giyqesora, te cilet menjehere, dhe gjithmone brenda 24 oreve, duhet te njohè autoritetin giyqesor. Ne rast se ky i fundit nuk sanksionon ate brenda 24 oreve pasardhese, sekuestrimi konsiderohet shfukizuar dhe pa kurrfere efkti.

Ligji mund te vendose, me norma te karakterit te pergjitshemqe te behen publike mietet e financimit te shtypit periodik.

Ndalohen botimet me shtyp, shfaqjet de te gjita manifestimet e tjera ne kundershtrim me moralin shoqeror. Ligji cakton masat e pershtatshme per

parandalimindhe ndeshkimin e shkeljeve.

Neni 22

Askuit nuk mund t'i hiqen, per shkaqe politike, zotesia juridike shtetesia, emri.

Neni 23

Asnje detyrim personal ose pasuror nuk mund te ventoset ne baze te ligjit.

Neni 24

Te gjithë mund t'i drejtohen giykates per mbrojtjen e te drejtave dhe interesave te tyre te ligjshme.

Mbrojtja eshte nje e drejte qe nuk mund te dhunohet ne gjendje e faze te procesit.

Personat qe nuk jane ne gjende, u sigurohen, me institutet posacme, mjetet per te vepruar dhe per t'u mbrojtur perparat juridiksioni.

Ligji percakton kushtet dhe menytrat per ndreqjen e gabineve giyqesore.

Neni 25

Askujt nuk mund t'i ndryshohet gjiqtari i natyrshem i paracaktuar me ligj.

Askush nuk mund te denohet, vecse ne beze te nje ligji qe te kete hyre ne fuqi perpara kryrjes se vepres.

Askush nuk mund t'u nenshtrohet masave te sigurimit, vecse ne rastet e parashikuara ne ligj.

Neni 26

Ekstradimi i shteetasit mund te lejohet vetem nese eshte i parashikuar shprehimisht ne konventat nderkombetare .

Ekstradimi nuk mund te lejohet ne asnje rast per vepra penale politike.

Neni 27

Pergjegjesa penale eshte vetjake.

I pandehuri nuk konsiderohet fajtor deri ne denimin perfundimtar.

Denimet nuk mund te jene trajtime ne kundërshtim me ndjenjat njerezore dhe duhet te synojne ne riedukimin e te denuarit.

Nuk lejohet denimi me vdekje, pervec rasteve te parashikuara nga ligjet ushtarake te kohes se luftes.

Neni 28

Funksionaret dhe nepunesit e Shtetit dhe te institucioneve publike jane pergjegjes drejtpersedrejti, sipas legjeve penale, civile dhe administrative, per veprimet e kryera duke shkelur te drejttat.

Ne raste te tilla pergjegjesa civile shtrihet te Shteti dhe tek institucionet publike.

Kreu II ***Marredheniet Etiko- Shoqerore***

Neni 29

Republika njeh te drejtat e familjes si shoqeri natyrore e bazuar ne martesen.

Martesa rregullohet mbi bazen e barazise morale e juridike te bashkeshorteve, brenda kufijve te caktuar me ligj per garantimin e unitetit familjar.

Neni 30

Eshte detyre dhe e drejte e prinderve mbajtja, arsimimi dhe edukimi i femijeve, edhe kur kane lindur jashte marteses.

Ne rastet e pazotesise se prinderve, ligji do te percaktoje menytrat se si do te kryhendetyrat qe u ngarkohen atyre.

Ligji u siguron femijeve te lindur jashte marteses cdo mbrojtje juridike e shoqerore, ne pajtim me te drejtat e anetareve te familjes se ligjshme.

Ligji percakton normat dhe kufijte per kerkimin e atesise.

Neni 31

Republika lehteson me masa ekenomike dhe perkujdesje tetjera krijimin e famijes dhe plotesimin e detyrave perkatese, me nje vemendje te vecante per famijet e medha.

Ajo mbron nenen, femijet dhe te rinjte, duke favorizuar institutet e nevojshme per kete qellim.

Neni 32

Republika kujdeset per shendetin si nje e drejte themelore e individit dhe nje interes i kolektivitetit, dhe garanton mjekime falas te skamurit. Aaskush nuk mund te detyrohet per nje trajtim shendetesor te percaktuar vecse me dispoziteligjore. Ligji ne asnje rast nuk mund te shkele kufijte qe imponon respekti per njeriun.

Neni 33

Ari dhe shkenca jane te lire dhe i lire eshte mesimi i tyre.

Republika cakton normat e pergjithshme per arsimin dhe krijon shkolla shteterore per te gjitha rendet dhe shkallet. Institucionet dhe privatet kane te drejte te krijojne shkolla dhe institute edukimi, pa shpenzime per Shtetin.

Ligji, ne percaktimin e te drejtave dhe detyrimeve te shkollave shteterore qe Kerkojne status te barabarte, duhet t'u siguroje atyre siguri te plote dhe nxenesve te tyre nje trajtim shkollor te barazvlefshem ne ate te nxenesve te shkollave shteterore.

Eshte i detyrueshem nje provim shteteror per pranimin ne shkollat e cfaredo rendi dhe shkalle ose per perfundimin e tyre dhe permiresimin ne ushtimin e profesionit. Institucionet e kultures se larte, universitetet dhe

akademite, kane te drejte te vendosin vete nje rend autonomie brenda kufijve te percaktuara nga ligjet e Shtetit.

Neni 34

Shkolla eshte e hapur per te gjithë. Arsimi i ulet, i dhene te pakten per tete vjet, eshte i detyrueshem dhe falas.

Ata qe jane te afte dhe qe e meritojne, edhe pse nuk i kane mundesite kane te drejte te arrijne shkallet me te larta te studimeve.

Kreu III

Raporti ekonomik

Neni 35

Republica kontrollon punen ne te gjita format e aplikimet e saje.

Kuron formimin dhe scritjen profesionale te punetoreve. Nxit dhe favorizon marreveshjet dhe organizat internacionale qe

kerkojne te bejne te njohur dhe te rregullojne te drejtat e punes. Njeh lirin e emigracionit, sipas detjimeve te vendosura nga ligje ne interesin e pergjthshem, dhe kontrollon punen e Italianeve jashte.

Neni 36

Punetori ka te drejten e nje pagese ne perpjestim me kualitetin dhe sasine e pune se tije dhe ne cdo rast e mjaftueshme per te siguruar vetes dhe familjes se tije nje eksistence te lire e me dinjitet maksimumi i oreve te punes ditore jane te percaktuara me ligj. Punetori ka te drejten e pushimit javore dhe pushimeve vjetore te paguara nga te cilat nuk mund te hege dore.

Neni 37

Gruaja qe punan ka te njejtat te drejta dhe barazi pune te njejtin page qe kane edhe punetoret. Hushtet e punes duhet te

lejojne permbushjen e funksionit te sajje esencial familjare dhe sigurimin per femijen dhe nenen, dhe nje mbrojtje te pershtateshme e speciale.

Ligji stabilizon limitin minimal te mashes per pune te paguar Republika kontrollan punen e te miturve me norma specifike dhe u garanton atyre ne punen e barabarte, te drejten e barazise se pages.

Neni 38

Cdo shtetas i paafte per pune dhe pa mjetet e nevojshme per te jetuare ka te drejte per mbajtjen dhe asistencen shoqerore.

Punonjesit kane te drejte qe te parashikohen dhe te sigurohen me mjete te pershtatshme per kerkesat e tyre jetike ne rast fatkeqesie, semundjeje, invaliditeti dhe pleqerie, papunesie pa dashje.

Te paafte dhe te gijmtuarit kane te drejte per edukimin dhe pergatitjen profesionale.

Per detyrat e parashikuara ne kete nen perkujdesen organe dhe institutet te ngritura ose te integruara nga Shteti.

Asistenca private eshte e lire.

Neni 39

Organizimi sindikal eshte i lire.

Sindikatave nuk mund t'u caktohet asnje detyrim, pervec regjistrimit te tyre prane zyraeve lokale a qendrore, sipas normave te ligjit.

Kusht per regjistrimin eshte qe statutet e sindikatave te sanksionojne nje rregullim te brendshem mbi baza demokratike.

Sindikatat e regjistruara kane personalitet juridik. Te perfaqesuara si nje trup i vetem ne perpjesetim me anetaret e tyre, ato mund te nenshkruajne kontrata kolektive pune te detyrueshme per te gjithë pjesetanaret e kategorive te cilave u referohet kontrata.

Neni 40

E drejta per greve ushtrohet ne kuadrin e ligjeve qe e rregullojne.

Neni 41

Nisma ekonomike private eshte e lire.

Ajo nuk mund te zhvillohet ne kundershtim me dobine shoqerore ose ne menyre qe i sjell dem sigurise, lirise, dinjitetit njerezor.

Ligji percakton programet dhe kontrollet e duhura qe veprimtaria ekonomike publike e private te mund te drejtohet e te bashkerendhoet per qellime shoqerore.

Neni 42

Prona eshte publike ose private. Pasurite ekonomike u perkasin Shtetit, institucioneve ose privateve.

Prona private njihet dhe garanttohet nga ligji, i cili percakton menytrat e fitimit te saj, te gizimit dhe kufite e saj, me qellim qe te sigurohet funksioni i saj

shoqeror dhe qe ajo te behet e arritshme per te gjithë.

Prona private mund te shpronosohet per shkaqe te interesit te pergjithshem, ne rastet e parashikuara nga ligji dhe kundrejt shperblimit.

Ligji percakton normat dhe kufijte e trashëgimise ligjore e me testament dhe te drejtat e Shtetit mbi trashëgimite.

Neni 43

Per synime te nje dobie te pergjithshme ligji mund te rezervoje qe ne fillim ose te kaloje, me ane shpronesimi dhe kundrejt shperblimit, ne dobi te Shtetit, te institucioneve publike ose te bashkesive punonjesish ose perdoruesish, ndermarrje te caktuara ose kategori ndermarrjesh qe kane te bejne me sherbime publike thelbesore ose me burime energji a me situate monopoli ne te cilat te mbizoteroje interesi i pergjithshem.

Neni 44

Me quellim qe te arrihet shfrytezimi racional I tokes dhe te vendosen marredhenie te drejta shoqerore, ligji I imponon detyrime prones private mbi token. Cakton kufij per shtrirjen e saj sipas krahinave dhe zonave bujqesore, inkurajon dhe imponon bonifikimin e tokave, chnderrimin e latifondeve dhe rimekembjen e njesive prodhuese; mdihmon pronen e vogel dhe te mesme.

Ligji percakton masa ne favor te zonave malore.

Neni 45

Republika njeh funksionin shoqeror te koopermit me karakter ndihme te ndersjelle dhe pa synime spekulimi privat. Ligji inkurajon dhe favorizon rritjen e tij me mjetet me te pershtashme dhe verifikon, me kontrollet e duhura, karakterin dhe qellimet e tij.

Ligji parashikon masa per mbrojtjen dhe zhvillimin e artizanatit.

Neni 46

Me synimin e ngritjes ekonomike e shoqerore te punes dhe ne harmoni me kerkesat e prodhimit, Republika njeh te drejten e punonjesve per te bashkepunuar, ne menytrat dhe ne kufijte e caktuar nga ligji, ne administrimin e ndermarrjeve.

Neni 47

Republika inkurajon dhe mbron kursimet ne te gjitha format e tyre; disiplinon, bashkerendon dhe kontrollon ushtrimin e kreditit.

Ajo favorizon perdorimin e kursimeve popullore per pronesine mbi banesen, per pronesine e drejtperdrejte ne bujqesi dhe per investimin aksionar te drejtperdrejte dhe te terthorte ne komplekset e medha prodhuese te vendit.

Kreu IV ***Marredheniet politike***

Neni 48

Jane zgjedhes te gjitheshtetasit, burra e gra, qe kane mbushur moshen madhore.

Vota eshte vetjake dhe e barabarte, e lire dhe e fshehte. Ushtrimi i saj eshte detyre qytetare.

E drejta e votes nuk mund te kufizohet vecse per pazotesi civile ose si pasoje e nje vendimi penal te formes se prere dhe ne rastet e padenjesise morale te percaktuara me ligj.

Neni 49

Te gjitheshtetasit kane te drejte te organizohen lirisht ne parti per te kontribuar me metoda demokratike ne percaktimin e politikes kombetare.

Neni 50

Te gjitheshtetasit mund t'u drejtojne peticione Dhomave per te kerkuar masa legislative ose per te

parashtruar nevoja te perbashketa.

Neni 51

Te gjithë shtetasit te te dy sekseve mund te marrin pjese ne poste publike ose ne funksione te zgjedhshme ne kushte barazie, sipas kerkesave te percaktuara me ligj.

Ligji mundet, per pranimin ne postet publike dhe ne funksione te zgjedhshme te barazoje me shtetasit vendas italianet qe nuk i perkasin republikes.

Kushdo qe eshte caktuar ne funksione publike te zgjedhshme ka te drejte te disponoje kohen e nevojshme per kryerjen e tyre dhe te rueje vendin e tij te punes.

Neni 52

Mbrojtja e Atdheut eshte detyre e shenje e shtetasit. Sherbimi ushtarak eshte i detyrueshem ne kufijte dhe menytrat e percaktuara ligj. Kryerja e tij nuk paragjykon poziten ne pune te shtetasit, as ushtrimin e te drejtave politike.

Organizimi i Forcave te Armatosura i pergjigjet frymes demokratike i Republikes.

Neni 53

Te gjithë kane per detyre te kontribuojne ne shpenzimet publike sipas aftesise se tyre kontribuese.

Sistemi fiskal ndertohet me kritere progresiviteti.

Neni 54

Te gjithë shtetasit kane per detyre te jene besnike ndaj Republikes ethe te respektojne Kushtetuten dhe ligjet.

Shtetasit te cileve u jane besuar funksione publike kane per detyre te kryejne me sisispline dhe nder, duke

bere betim ne rastet e percaktuara me ligj.

PJESA E DYTE ORGANIZIMI I REPUBLIKES

Kreu I Parlamenti

Seksioni I Dhomat

Neni 55

Parlamenti perbehet nga Dhoma e deputeteve dhe nga Senati i Republikes.

Parlamenti mblidhet ne seance te perbashket te anetareve te te dy dhomave vetem ne rastet t parashikuara nga Kushtetuta.

Neni 56

Dhoma e deputeteve zgjidhet me zgjedhje te

pergjithshme dhe te drejtperdrejta.

Numri i deputeteve shte 630.

Mund te sgjidhen deputeteve te gjithe zgjedhesit, te cilet ditet e zgjedhjeve kane mbushur 25 vjet.

Ndarja e vendeve midis zonave elektorale kryhet duke e ndare numrin e banoreve te Republikes. Sic rezulton nga regjistrimi i fundit i pergjithshem i popullsine, per 630 dhe duke i shperndare vendet ne perpjesetim me popullsine ne cdo zone elektorale, mbi bazen e heresve te plote dhe te mbetjeve me te larta.

Neni 57

Senati i republikes zgjidhet mbi baze regjionale.

Numri i senatoreve te zgjedhur eshte 315.

Asnje Regjion nuk mund te kete nje numer me te pakte se shtate senatore; Molize ka dy; Val d'Aosta nje.

Ndarja e vendeve ndermjet Regjioneve, duke zbatuar dispozitat e paragrafit paraardhes, kryhet ne perpjesetim me popullsine e regjioneve, sic rezulton nga regjistrimi i fundit i pergjithshem, mbi bazen e heresve te plote dhe te mbetjeve me te larta.

Neni 58

Senatoret zgjidhen me zgjedhje te pergjithshme dhe te drejtperdrejta nga zgjedhes qe e kane kaluar moshen 25 vjecare. Mund te zgjidhen senatore zgjedhesit qe mbushur 40 vjet.

Neni 59

Eshte senator me te drejte dhe i perjetshem, pervecse kur heq dore. Ai qe ka qene President i republikes. Presidenti i Republikes mund te emeruje senatore te perjetshem pese shtetas qe e kane nderuar atdheun per merita shume te larta ne fushen shoqerore,

shkencore artistike dhe letrare.

Neni 60

Dhoma e deputeteve dhe Senati i Republikes zgjidhen per pese vjet. Mandati i seciles Dhome nuk mund te zgjatet vecse me ligj dhe vetem ne rast lufte.

Neni 61

Zgjedjet e Dhomave te reja behen brenda 70 ditenga mbarimi i Dhomave te meparshme. Mbledhja e pare behet vone se 20 dite pas zgjedhjeve. Deri ne mbledhjen e Dhomave te reja vazhdojne pushtetin ato te meparshme.

Neni 62

Dhomat mblidhen vetiu ditene e pare jo festive te shkurtit e tetorit. Secila Dhome mund te thirret ne sesion te jashtezako neshme menisme te Kryetarit te saj ose te Presidentit te Republikes ose 1/3 tertes se

pjesetareve te say. Kur njera Dhome mblidhet ne sesion te jashtezakonsheur vetiu edhe tjetra.

Neni 63

Secila Dhome zgjedh nder anetaret e saj krjetarin dhe zyren e Kryesise.

Kur Parlamenti mblidhet ne seance te perbashket, Kryesia dhe Bryoja e Kryesise jane ata te Dhomes se deputeteve.

Neni 64

Secila Dhome miraton rregulloren e vet me shumicen absolute te anetareve te saj.

Seancat jane publike megjithate secila nga te dy Dhomat dhe Parlamenti ne mbledhjen e tyre te perbashket mund te vendosin mblidhen ne seance te mbyllur.

Vendimet e seciles Dhome dhe te Parlamentit nuk jane te vlefshme po te mos jete e pranishme shumica e anetareve te saje dhe po te mos jene miratuar nga

shumica e te pranishmeve, pervecse kur Kushtetuta parashikon nje shumice te cilesuar.

Anetaret e Qeverise, edhe kur nuk jane anetare te Dhomave, kane te drejte dhe, po t'u kerkohet, detyrim qe te asistojne ne seancat. Ata duhet te degjohen cdo here qe e kerkojne.

Neni 65

Ligji percakton rastet e pezgjedhshmerise dhe te papajyueshmerise me funksionin e deputetit ose te senatorit.

Askush nuk mund te beje pjese njekoheisht ne te dy Dhomat.

Neni 66

Secila Dhome gjykon per vlefshmerine e pranimi te anetareve te saj dhe pershkaqet, qe mund te jene vertetuar me vone, te pazgjedhshmerise dhe te papajtuueshmerise.

Neni 67

Cdo anetar i Parlamentit perfaqeson Kombin dhe i ushtron funksionet e tij pa mandat detyrues.

Neni 68

Anetaret e Parlamentit nuk mund te ndiqen per mendimet e shprehura dhe per voten e dhene gjate ushtrimit te funksioneve te tyre.

Pa autorizim te Dhomes ku ben pjase, asnje anetar i Pralmentit nuk mund t'i nenshtrohet ndjekjes penale, as nuk mund te arrestohet, ose te privohet ne cdo menyre tjeter nga liria vetjake, ose t'i nenshtrohet kontrollit vetjak ose te shtepise, pervecse po te jete zene ne castin e kryerjes se nje krimi per te cilin eshte i detyrueshem mandati ose urdheri i arrestit.

I njehti autorizim kerkohet per arrestimin ose mbajtjen ne burg te nje anetari te Parleментit ne zbatim te nje

vendimi, qofte edhe te formes se prepe.

Neni 69

Anetaret e Parlamentit marrin nje shperblim te caktuar me ligj.

Seksioni II

Formimi i ligjeve

Neni 70

Funksioni ligjvenes ushtrohet kolektivish nga te dy Dhomat.

Neni 71

Nisma ligjvenese u perket Qeverise, cdo anetari te Dhomave si dhe organeve dhe institucioneve te cilave ajo u njihet nga ligji kushtetues.

Polulli e ushtron nismen ligjvenese, me ane te propozimit, prej se paku 50.000 zgjedhesve, te nje projekti te formuluar ne nene.

Neni 72

Cdo projektligj, i paraqitur ne njerën Dhomë, sipas normave të rregullores së saj, shqyrtohet nga një komision dhe pastaj nga vete Dhoma, që e miraton nën për nën me një votim përfundimtar.

Rregullorja cakton procedurën të përshpejtuara për projektligje që çilesohen si urgjente.

Ajo mund të caktojë gjithashtu në cilat raste dhe forma shqyrtimi dhe miratimi i projektligjeve mund t'u ngarkohet komisioneve, edhe të përherëshme, të përbera në mënyrë që të pasqyrohet përpjesëtimi i grupeve parlamentare. Edhe në raste të tilla, deri në castin e miratimit të tij përfundimtar, projektligji i përshtrëhet Dhomes, në qoftë se Qeveria ose një e dhjetë e anëtarëve të Dhomes. Ose një e pesta e Komisionit kerkojnë që ai

të diskutohet ose të votohet nga vete Dhoma ose t'i nënshtrohet miratimit përfundimtar të saj vetëm me punimeve të komisioneve.

Procedura normale e shqyrtimit dhe e miratimit të drejtperdrejtë nga ana e Dhomes vendoset gjithmone për projektligjet në fushën kushtetuese dhe elektorale dhe për ato të delegimit ligjvëbes, të autorizimit për ratifikim traktatesh nderkombetare, të miratimit të buxheteve dhe të raporteve konsultive.

Neni 73

Ligjet shpallen nga Presidenti i Republikës brenda një muaji nga miratimi.

Në rast se Dhomat, secila me shumicë absolute të anëtarëve të vet, e çilesojnë si urgjent, ligji shpallet në afatin e caktuar në të.

Ligjet botohen menjëherë pas shpalljes dhe hyjnë në fuqi 15 ditë pas botimit,

pervecse kur vete ligjet vendosin nje afat tjeter.

Neni 74

Presidenti i Republikes, perpara shpalljes se ligjit, mund te kerkoje nje vendim te ri, me nje mesazh te arsyetuar drejtuar Dhomave.

Ne rast se Dhomat e miratojne perseri ligjin, ky duhet te shpallet.

Neni 75

Shpallet referendumi popullor per te vendosur shfuqizimin, teresor a te pjesshem, te nje ligji ose te nje akti qe ka vleren e ligjit, kur e kerkojne 500.000 zgjedhes ose pese Keshilla regjionale.

Nuk lejohet referendum per ligjet fiskale dhe buxhetore, te amnistise dhe te fakjes, te autorizimit per ratifikim traktatesh nderkombetare. Kane te drejte te marrin pjese ne referendum te gjithë shtetasit qe mund te zgjedhin Dhomen e deputateve.

Propozimi qe shtrohet per referendum miratohet ne rast se ka marre pjese ne votim shumica e atyre qe e kane kete te drejte, dhe ne rast se eshte arritur shumica e votave te vlefshme.

Ligji percakton modalitetet e zhvillimit te referendumit.

Neni 76

Ushtrimi i funksionit ligjvenes nuk mund t'i delegohet Qeverise vecse kur percaktohen parimet dhe kriteret drejtuese dhe vetem pert nje kohe te kufizuar dhe per objekte te percaktuara.

Neni 77

Qeveria nuk mund, pa delegimin e Dhomave, te nxjerre dekrete qe kane vleren e ligjit te zakonshem.

Kur, ne raste te jashtezakonshme domosdoshmerie dhe urgjence, Qeveria, nen pergjegjesine e vet, merr masa te perkohshme qe

kane fuqine e ligjit, duhet po ate dite t'ua paraqite per t'i kthyer ne ligj Dhomave, te cilat, edhe po te jene te shperndara, thirren enkas dhe mblidhen brenda pese diteve.

Dekret e humbasin fuqine qe nga fillimi, ne rast se nuk kthehen me ligj brenda 60 diteve qe nga botimi i tyre. Megjithate Dhomat mund te rregullojne me ligj marredheniet juridike te lindura mbi bazen e dekreteve te pakthjera ne ligj.

Neni 78

Dhomat vendosin per gjendjen e luftes dhe i japin Qeverise pushtetet e nevojshme.

Neni 79

Amnistia dhe falja jepen nga Presidenti i Republikes nbi bazen e ligjit te delegimit nga ana e Dhomave.

Ato nuk mund te zbatohen per veprat penale

te kryera pas propozimit te delegimit.

Neni 80

Dhomat autorizojne me ligj ratifikimin e trakteve nderkombetare qe jane te karakterit politik, ose qe parashkojne arbitrazhe e rregullime gjyqesore, ose sjellin ndryshime territoriale a barra financiare ose ndryshime te ligjeve.

Neni 81

Dhomat miratojne cdo vit buxhetin dhe konsuntiv te paraqitur nga Qeveria.

Ushtrimi i perkohshem i buxhetit nuk mund te lejohet vecse me ligj dhe per periudha qe ne teresi nuk i kalojne kater muajt.

Me ligjin e miratimit te buxhetit nuk mund te vendosen taska te reja ane shpenzime te reja.

Cdo ligj tjeter qe sjell shpenzime te reja e me te medha duhet te tregojte mjetet per t'i perballuar.

Neni 82

Secila Dhome mund te vendose zhvillim e antketave per ceshtje te interesit publik.

Per kete qellim ajo emerone me anetare te saj nje komision te perbere ne meyre qe te pasqyrohet perpjesetimi i grupeve te ndryshme. Komisioni hetimor i kryen hetimet dhe shqyrtimet me te njejtat pushtete dhe te njejtat kufizime te autoritetit giyqesor.

Kreu II ***Presidenti i Republikes***

Neni 83

Presidenti i Republike zgjidhet nga Parlamenti ne seance te perbashket te anetareve te tij.

Ne zgjedhjen marrin pjese tre delegate per cdo Regjion te zgjedhur nga Keshilli regjional ne menyre qe te sigurohet perfaqesimi i minoriteteve. Val d'Aosta ka vetem nje delegat.

Zgjedhja e Parlamenti te Republikes behet me votim te fshehte me nje shumice prej dy te tretash te asamblese. Pas votimit te trete mjafton shumica absolute.

Neni 84

Mund te zgjidhet Presidenti i Republikes cdo shtetas qe ka mbushur 50 vjet gezon te drejtat civile dhe politike.

Funksioni i Presidentit te Republikes eshte i papajtueshem me cdo detyre tieter.

Shperblimi dhe mjetet ne dispozicion te Presidentit caktohen me ligj.

Neni 85

Presidenti i Republikes zgjidhet per shtate vjet.

Tridjete dite perpara mbarimit te mandati, Kryetari i Dhomes se deputeteve therret ne seance te perbashket Parlamentin dhe delegatet regjionale, per te zgjedhur

Presidentin e ri te Republikes.

Ne rast se Dhomat jane te shperndara, ose kur duhen me pak se tre muaj qe te mbaroje mandati i tyre, zgjedhja doo te behet brenda pesembedhete diteve pas mbledhjes se Dhomave te reja. Nderkaq zgjatet mandati i Presidentit ne fuqi.

Neni 86

Funksionet e Presidentit te Republikes, ne cdo rast kur ai nuk mund t'i kryeje, ushtrohen nga Kryetari i Senatit.

Ne rast ndalimi te persheshem ose vdekjeje ose doreheqjeje te Presidentit te Republikes, Kretari i Dhomes se deputeteve cakton zgjedhjen e Presidentit te ri brenda pesembedhete diteve, pervecse kur eshte parashkikuar afati me i gjate nese Dhomat jane shperndara ose kur duhen me pak se tre muaj qe mbaroje mandati i tyre.

Neni 87

Presidenti i Republikes eshte kryetari i Shtetit dhe perfaqeson unitetin kombetar.

Mund t'u drejtoje masazhe Dhomave.

Cakton zgjedhjet e Dhomave te reja dhe mbledhjen e pare te tyre.

Autorizon paraqitjen Dhomave te projektligjeve me nismen e Qeverise.

Shpall ligjet dhe nxjerr dekretet qe kane vleren e ligjit si dhe rregulloret.

Shpall referendumin popullor ne rastet e parashikuara nga Kushtetuta.

Emeron, ne rastet e caktuara nga ligji, funksionaret e Shtetit.

Akrediton dhe pranon perfaqsesit diplomatike, ratifikon traktatet nderkombetare, duke marre kur duhet, autorizimin e Dhomave.

Ka komanden e Forcave te Armatosura, kryeson Keshillin e Larte te

Mbrojtjrs i formuar sipas ligjit, shpall gjendjen e luftes te vendosur nga Dhomat.

Krejeson Keshillin e Larte te Drejtesise.

Mund te jape faljen dhe te ndryshoje denimet.

Jep titujt e nderit te Republikes.

Neni 88

Presidenti i Republikes, pasi degjon Kretaret e tyre, mund te shperndaje Dhomat ose edhe vetem njereren prej tyre.

Kete kompetence nuk mund ta ushtroje ne gjashte muajt e fundit te mandatit te tij.

Neni 89

Asnje akt i Presidentit i Republikes nuk eshte i vlefshem pa kunderfirmen e ministrave propozues, te cilet marrin persiper pergjegjesine.

Aktet qe kane vlere ligjore dhe aktet te tiera te caktuara nga ligji kunderfirmohen edhe nga

Kryetari i Keshillit te Ministrave.

Neni 90

Presidenti i Republikes nuk pergjigjet per veprimet e kryera gjate ushtrimit te funksionit te tij, pervecse per tradhti te larte ose per shkelje te Kushtetutes.

Ne raste te tilla vihet ne gjendje azuke nga Parlamenti ne seance te perbashket, me shumicen absolute te anetareve te tij.

Neni 91

Presidenti i Republikes, perpara se te filloje nga funksionet e tij, ben betim per besnikeri ndaj Republikes dhe per rrspektimin e Kushtetutes perpare Parlamentit ne seance te perbashket.

Kreu III ***Qeveria***

Seksion I ***Keshilli i Ministrave***

Neni 92

Qeveria e Republikës perbehet nga Kryetari i Keshillit dhe nga Ministrat, te cilet formojne se bashku Keshillin e Ministrave.

Presidenti i Republikës emerone Kryetarin e Keshillit te Ministrave ethe, me propozimin e ketij, ministrat.

Neni 93

Kryetari i Keshillit te Ministrave dhe ministrat, prepara se te pranojne nga funksionet e tyre, betohen perpara Presidentit te Republikës.

Neni 94

Qeveria duhet te kete besimin e te dy Dhomave. Secila Dhome ose e mohon besimin me ane te nje mocioni te aresyetuar dhe te puar me apel emeror.

Brenda pesembedhjete diteve qe nga formimi i saj Qeveria raqitet perpara Dhomave per te marre votebesimin.

Votimi kunder nje propozimi te Qeverise nga

njera. Dhome ose te dyja, nuk ka si pasoje detyrimin per te dhene doreheqjen.

Mocioni i mosbesimit duhet te nenshkruhet prej se paku nje te jeten e anetareve te Dhomes dhe nuk mund te diskutohet perpara enditeve qe nga paraqitja e tij.

Neni 95

Kretari i Keshillit te Ministrave drejton politiken e pergjithshme te Qeverise dhe pergjigjet per te. Ai siguron unitetin e drejtimin politik dhe administrativ, dhe nxitur dhe bashkerenduar veprimtarine e ministrave.

Ministrat pergjigjen kolegjalisht per aket e Keshillit te Ministrave dhe individualisht per aktet e dikastevere te tyre.

Ligji parashikon organizimin e Kryeministrise dhe cakton numrin, kompetencat dhe organizimin e ministrive.

Neni 96

Kryetari i Keshillit te Ministrave dhe ministrat vihen ne gjenje akuze nga Parlamenti ne seance te perbashket per vepra penale te kryera gjate ushtrimit te funksioneve te tyre.

Seksioni II *Administrata publike*

Neni 97

Zyrat publike organizohen sipas dispozitave te ligjit, ne menyre qe te sigurohen mbarevajtja dhe paanesia e administrates.

Ne organizimin e ayrave percaktohen sferat e kompetences, atributet dhe pergjegjesite e funksionareve.

Nepunesit ne administrat publike caktohen me konkurs, me perjashtim te rasteve te parashikuara me ligj.

Neni 98

Nepunesit publike jane ne sherbimin ekskluziv te Kombit

Ne rast se jane anetare te Parlamentit, ata nuk mund te gradohen vecse per vjetersi ne pune Me ligj mund te vendosen kufizime per te drejten e pjesemarrjes ne parti politike per gjyqtaret, per ushtaraket profesioniste ne sherbim aktiv, per funksionaret dhe agjentet e policise, per perfaqesuesif Diplomatike e konsullore jashte vendit.

Seksioni III *Organet ndihmese*

Neni 99

Keshilli kombetar i ekonomise dhe i punes eshte i formuar, ne menyrat e caktuara me ligj, nga eksperte dhe perfaqesues te kategorive prodhuese, duke pasur parasysh rendesine e tyre numerike dhe cilesore. Asi eshte organ keshillimor i Dhomave dhe i Qeverise per fushat dhe sipas

fankcioneve qe i jane caktuar me ligj.

Ai ka nismen ligjvenses dhe mund te kontribuojne ne perpunimin e legjislacionit ekonomik e shoqeror sipas parimeve dhe brenda kufijve te caktuar nga ligji.

Neni 100

Keshilli i Shtetit eshte organ per konsulence juridiko-administrative dhe mbikqyrjen e drejtesise ne administrate.

Gjykata e llogarive ushtron kontrollin paraprak te ligjshmerise mbi aktet e Qeverise si dhe ate te metejshem per administrimin e buxhetit te Shtetit.

Ajo merr pjese, ne rastet dhe ne format e caktuara nga ligji, ne kontrollin mbi administrimin financiar te institucioneve te cilave Shteti u jep kontribute ne rruge te zakonshme. Ajo raporton drejtpersedretjti perpara Dhomave per

perfundimet e kontrolli te kryer.

Ligji siguron pavaresine e te dy Instituteve dhe te anetareve te tyre ndaj Qeverise.

Kreu IV ***DREJTESIA***

Seksioni I ***Organizimi gjyqesor***

Neni 101

Drejtesia jepet ne emer te polullit. Gjyqtaret i nenshtrohen vetem ligjit.

Neni 102

Funksioni gjyqesor ushtrohet nga gjyqtare te caktuar e te rregullar nga normat per organizimin gjyqesor.

Nuk mund te kete gjyqtare te jashtezakonshem ose gjyqtare te posacem.

Mund te krijohen vetem prane organeve gjyqesore te

zakonshme seksione te specializuara per fushe te caktuara, edhe me pjesemarrjen e shtetasve te afte qe jane jashte drejtesise.

Ligji rregullon rastet dhe format e pjesemarrjes se drejtperdrejte te popullit ne dheninen e drejtesise.

Neni 103

Keshilli i Shtetit dhe organet e tjera te drejtesise administrative kane jurisdikcion per mbrojtjen kundfrejt administrates publike te interesave te ligjshme dhe, ne fusha te vecanta te caktuara nga ligji, edhe te te drejtave subjektive.

Gjykata e llogarive ka jurisdikcion ne fushat e kontabilitetit publik dhe ne fushat e tjera te percaktuara nga ligji.

Gjykata ushtarake ne kone lufte kane jurisdikcionin e caktuar me ligj. Ne kobe paqeje kane jurisdikcion vtem per veprat penale te te

kryera nga pjesetare te Forcave te Armatosura.

Neni 104

Drejtesia perben nje rend autonom dhe te pavanir nga cdo fugi tjeter.

Keshilli i Larte i Drejtesise kryesohet nga Presidenti i Republikes. Marrin pjese vetiu ne te Kryetari i pare dhe prokurori i pergjithshem i Gjykates se Kasacionit.

Pjesetaret e tjere zgjidhen, per dy te tretat, nga te gjithë gjyqtaret e midis pjesetareve te kategorive te ndryshme dhe, per nje te tnetatnga Parlamenti ne seance te perbashket, midis profesoreve e te universitetit ne lende juridike dhe avokateve me nje vjetersi mbi pesembedhjete vjet.

Keshilli zgjedh nje zevendes kryetar midis pjesetareve te caktuar Parlamenti.

Pjesetaret e zgjedhur te Keshillit qendrojne ne detyre kater vjet e nuk mund te rizgidhen

menjehere. Deri sa kryejne kete detyre, ata nuk mund te jene te regjistruar ne regjistrin profesional dhe as te jene anetare te Parlamentit ose te Keshilli regjional.

Neni 105

Keshilli i Larte i Drejtesise ka ne kompetence, sipas normave te organizimit gjyqesor, pranimet, emerimet dhe transferimet, gradimet masat disiplinore persa u perket gjyqtareve.

Neni 106

Emerimet e gjyqtareve behen me konkurs. Ligji i organizimit gjyqesor mund te pranoje emerimin, edhe me zgjedhje, te gjyqtareve jo efektive per te gjitha funksionet qe u caktohen gjyqtareve individuale. Me caktim te Keshillit te Larte te Drejtesise mund te terhiquen si keshilltare kasacioni per merita te shquara, profesore ordinare universiteti ne lende

juridike dhe avokate qe te kene praktike pesembedhjetevjecare dhe jene te regjistruar ne regjistrat e posacem per juridiksionet eprore.

Neni 107

Gjyqtaret nuk mund te levizen. Ata nuk mund te pushohen ose te pezullohen dhe as caktohen ne seli ose funksione te tjera, vecse ne vijim te nje vendimi te Keshillit te Larte te Drejtesise, te marre per motivet dhe per garancite e mbrojtjes te vendosura ne kuadrin e organizimit gjyqesor ose me pelqimin e tyre.

Ministri i Drejtesise ka kompetence te filloje ndjekje disiplinore.

Gjyqtaret dallohen midis tyre vetem per ndryshimin e funksioneve. Prokurori gezon garancite e caktuara per te nga normat e organizimit gjyqesor.

Neni 108

Normat e organizimit gjyqesor per cdo lloj gjykate vendosen me ligj. Ligji siguron pavaresine e gjyqtareve te jurisdiksioneve te posacme, te prokurorit prane tyre, dhe te personave te jashtem qe marrin pjese ne dhenien e drejtesise.

Neni 109

Autoriteti gjyqesor ka ne dispozicion te drejtperdrejte policine gjyqesore.

Neni 110

Pa prekur kompetencat e Keshilliut te Larte te Drejtesise, Ministrit te Drejtesise i perkasin organizimin dhe funksionimi i sherbimeve qe kane lidhje me drejtesine.

Seksioni II

Normat e jurisdiksionit

Neni 111

Jurisdiksioni aplikohet nepermjet procesit te duhur te vendosur nga ligji. Cdo

proces zhvillohet ne kontradikte midis pjesëve, ne kushte barazie, perpara nje gjykatësi te jashtem dhe te drejte. Ligji siguron zgjatjen e arsyeshme.

Ne procesin penal, ligji siguron, qe personi i akuzuar per nje krim, te jetë ne kohën me te shkurtër, i informuar privatisht per natyrën dhe motivet e akuzës, qe janë ne ngarkim te tij; te ketë ne dispozicion kohë dhe kushte te nevojshme per te pregatitur mbrojtjen e tij; te ketë aftësinë perpara gjykatësit, qe te pyesë ose te pyesin personat, qe bëjnë deklarime mbi të; te arrijë te marrë thirrjen dhe pyetjen e personave ne mbrojtje te tij, ne te njëjtat kushte te akuzës dhe blerjen e cdo lloj prove tjetër ne favor te tij; te jetë i asistuar nga nje perkthyes, neqoftese nuk kupton ose nuk flet te njëjtën gjuhë qe flitet tek procesi.

Proçesi penal është i rregulluar nga parimi i

kundërshtimit në formimin e provës. Fajësia e të pandehurit nuk mund të provohet mbi bazën e deklaratave të bëra nga, ai, që për zgjedhje të lirë, nuk ka dashur asnjëherë që të merrej në pyetje nga i pandehuri ose nga mbrojtësi i tij.

Ligji vendos rastet në të cilat, formimi i provës nuk zë vend në kundërshtim me miratimin e të pandehurit ose për pamundësi të shqyrtuar me natyrë objektive ose për efekt të provuar të sjelljes së paligjshme.

Të gjitha masat juridiksionale duhet të jenë të arsyetuara.

Kundër vendimeve dhe kundër masave mbi lirinë personale, të shqiptuara nga organet juridiksionale ordinare apo speciale, është pranuar gjithëmonë kërkesa në Organin e Lartë të Drejtësisë për shkeljen e ligjit.

Mund të hiqet dorë nga kjo normë, vetëm për vendimet

e Gjykatave ushtarake në kohë lufte.

Kundër vendimeve të Këshillit të Shtetit dhe të Organit Gjykses, kërkesa në Kasacion pranohet vetëm për motive që i takojnë Jurisdiksionit.

Neni 112

Prokurori ka detytim të ushtrojë ndjekjen penale.

Neni 113

Kunder akteve të administrates publike lejohet gjithmone mbrojtia gjyqesore e te drejtave dhe interesave te ligjshme perpara organeve te juridiksionit te zakonshem ose administrativ.

Nje mbrojtje e tille gjyqesore nuk mund te perjashtohet a te kufizohet ne mjete te vecanta ankimi ose per kategori te caktuara aktesh.

Ligji percakton cilat organe gjyqesore mund te shfuqizojne aktet e administrates publike ne

rastet dhe me rrjedhojat e parashikuara nga vete ligji.

Kreu V
Regjionet, provincat dhe
komunat

Neni 114

Republika përbëhet nga njësitë administrative të Bashkive, Provincave, Qyteteve Metropolitane, Krahinave dhe nga Shteti.

Bashkitë, Provincat, Qytetet Metropolitane dhe Krahinat janë institucione administrative të pavarura me statute normative të veta, fuqi dhe funksione të tyre të veçanta, sipas parimeve të përcaktuara nga Kushtetuta.

Roma është kryeqyteti i Republikës. Ligji i Shtetit disiplinon rendin dhe regjimin e saj juridik.

Neni 115

është anuluar sipas ligjit kushtetues nr. 3 të datës 18 Tetor 2001

Neni 116

Friuli-Venecia Xhulia, Sardenja, Siçilia, Trentino-Alto Adixhe e Vale D'Aosta disponojnë dhe u njihen forma dhe kushte të veçanta autonomie, sipas statuteve të posaçme të aprovuara me ligje kushtetuese.

Krahina e Trentino-Alto Adixhes është e përbërë nga provincat autonome të Trentos dhe të Bolxanos.

Forma të mëtejshme dhe kushte të veçanta autonomie, që kanë të bëjnë me çështjet për të cilat flitet në paragrafin e tretë të Nenit 117 dhe çështjet e treguara në paragrafin e dytë të të njëjtit Nen në gërmën *l)*, përsa i përket organizimit të drejtësisë civile, *n)* e *s)*, mund t'i atribuohen Krahinave të tjera me ligj shtetëror, me nismën e Krahinës së interesuar dhe duke u këshilluar me institucionet vendore konform parimeve të përmendura në Nenin 119. Ligji miratohet nga të dyja Dhomat e Parlamentit

(Senati dhe Dhoma e Deputetëve) me mazhorancë absolute duke u bazuar dhe në mirëkuptimin midis Shtetit dhe Krahinës së interesuar.

Neni 117

Pushteti Ligjvënës ushtrohet nga Shteti (pushteti qendror) dhe nga Krahinat duke respektuar Kushtetutën dhe detyrimet e tjera që vijnë nga normat juridike të Bashkimit Evropian dhe nga detyrimet ndërkombtare.

Shteti ka të drejtën e ligjvënies ekskluzive në lëndët dhe në çështjet që vijojnë:

a) politika e jashtme dhe marrëdhëniet ndërkombtare të Shtetit; marrëdhëniet e Shtetit

me Bashkimin Evropian; e drejta e azilit dhe kushtet juridike të nënshtetasve të

shteteve që s'bëjnë pjesë në Bashkimin Evropian;

b) imigrimin e shtetasve të huaj brenda truallit italian;

c) marrëdhëniet e Republikës me besimet fetare;

d) Mbrojtja e Forcave të Armatosura; siguria e Shtetit; armët;

e) monedha, mbrojtja e kursimeve dhe e tregjeve financiare; mbrojtja e konkurrencës

së lirë; sistemi valutor; sistemi tributar e kontabël i Shtetit; përdorimi i mirë-ekuilibruar i burimeve financiare;

f) organet e Shtetit dhe ligjet elektorale; referendumet në rang kombtar; zgjedhja e

Parlamentit Evropian;

g) rendi dhe organizimi administrativ i Shtetit dhe i institucioneve publike kombtare;

h) rendi publik dhe siguria, me përjashtim të policisë administrative lokale;

i) nënshtetësia, zyrat e regjistrimit anagrafik dhe të gjendjes civile;

l) jurisdiksioni dhe rregullat procesuale; rendi civil e

penal; drejtësia administrative;

m) përcaktimi i niveleve minimale të shërbimeve, që kanë të bëjnë me të drejtat qyte-

tare dhe shoqërore, që duhen garantuar në mbarë territorin kombtar;

n) normat e përgjithshme mbi arsimin;

o) asistenca sociale dhe pensionet;

p) legjislacioni elektoral, organet e qeverisjes dhe funksionet themelore të Bashkive,

Provincave dhe Qyteteve Metropolitane;

q) doganat, mbrojtja e kufirit kombtar;

r) peshat, masat dhe përcaktimi kohor; koordinimi informativ-statistikor e informa-

tik i të dhënave të administratës shtetërore, krahinore dhe lokale; veprat e mëdha;

s) mbrojtja e mjedisit, e ekosistemit dhe e objekteve kulturore;

Janë çështje dhe lëndë të legjislacionit konkurent, në të cilat marrin pjesë në ligjvënien si Shteti ashtu dhe organet lokale dhe krahinore, ato që kanë të bëjnë me: marrëdhëniet ndërkombtare dhe me Bashkimin Evropian të Krahinave; tregtia me jashtë; mbrojtja dhe siguria në vendin e punës; arsimi, përjashtuar autonomia e institucioneve shkollore dhe arsim-formimit profesional; profesionet; kërkimet dhe studimet shkencore, teknologjike dhe mbështetja ndaj rinovimit të sektoreve produktive; mbrojtja e shëndetit; ushqimi; rendi sportiv; mbrojtja civile; qeverisja e territorit; portet dhe aeroportet civile; rjetet e mëdha të transportit dhe të lundrimit;

Rendi i komunikimit; prodhimi, transporti dhe shpërndarja kombtare e energjisë; previdenca komplementare dhe integrative si p.sh sigurimi shoqëror në vendin e punës

në rast dëmtimi a plagosje; harmonizimi i bilanceve publike dhe koordinimi i financës publike e i sistemit tributar; vlerësimi i të mirave dhe objekteve kulturore e mjedisore dhe promovimi dhe organizimi i aktiviteteve kulturore; arkat e kursimit; arkat e bankat agrare; ndërmarrjet e kredisë me karakter rajonal; në lëndët e legjislacionit konkurent i takon Krahinave pushteti legjislativ, përveç rasteve të përcaktimit të parimeve themelore, lëndë kjo e rezervuar për legjislacionin shtetëror, pra për pushtetin qendror.

I takon Krahinave pushteti legjislativ në çdo lëndë të par rezervuar shprehimisht Shtetit, pushtetit qendror.

Krahinat dhe Provincat autonome të Trentos dhe Bolxanos, në lëndët që hyjnë në kompetencat e tyre, marrin pjesë në vendimarrjet për formimin e akteve normative të Bashkimit Evropian dhe

bëjnë të mundur zbatimin dhe ekzekutimin e marrëveshjeve ndërkombtare e të akteve normative të Bashkimit Evropian duke respektuar normat dhe rregullat e procedurës të miratuara me ligj Shteti, që përcakton mënyrat e ushtrimit të veprimeve zëvendësuese në rast mospërbushje të detyrimeve, që rrjedhojnë nga aktet e lartpërmendura. Pushteti dhe kompetenca e bërjes së rregulloreve-burim dytësor normativ, që renditet fill pas ligjit, i takon Shtetit në lëndët e kompetencës ligjvënëse ekskluzive të tij, përjashtuar rastet kur ky i fundit i delegon këtë mundësi Krahinave. Pushteti dhe kompetenca e bërjes së rregulloreve i takon Krahinave në të gjitha lëndët që mbeten. Bashkitë, Provincat dhe Qytetet Metropolitane kanë kompetenca në këtë fushë vetëm kur disiplinojnë normativisht organizimin

dhe zhvillimin e funksioneve që u janë atribuar atyre.

Ligjet Krahinore heqin çdo pengesë, që nuk lejon barazinë e plotë midis meshkujve e femrave në jetën shoqërore, kulturore e ekonomike dhe realizojnë barazinë midis tyre në postet zgjedhore.

Ligji Krahinor ratifikon-miraton duke marrë brenda tij, marrëveshjet e Krahinave midis njëra-tjetrës për një ushtrim më të mirë të funksioneve të tyre, madje edhe duke formuar organe të tyre të përbashkëta.

Në lëndët e kompetencës së saj, Krahina mund të bëjë marrëveshje me Shtete dhe institucione territoriale e vendore të brendshme të një Shteti tjetër, në rastet dhe në format e miratuara nga ligjet e Shtetit.

Neni 118

Funksionet administrative u atribuohen Bashkive përveç rasteve, ku për të

siguruar një ushtrim sa më unitar e uniform të tyre, u kalojnë për t'u ushtruar Provincave, Qyteteve Metropolitane, Krahinave e Shtetit mbi bazën e parimeve të deçentralizimit, diferencimit, përshtatshmërisë.

Bashkitë, Provincat dhe Qytetet Metropolitane janë titullare të funksioneve të veta administrative dhe të atyre që u jepen me ligj shtetëror o krahinor sipas kompetencave përkatëse.

Ligji Shtetëror rregullon format e koordinimit midis Shtetit dhe Krahinave në lëndët e trajtuara në gërmat *b)* e *h)* të paragrafit të dytë të Neni 117, rregullon gjithashtu format e mirëkuptimit dhe të marrëveshjeve mbi mbrojtjen e të mirave dhe objekteve kulturore.

Shteti, Krahinat, Qytetet Metropolitane, Provincat dhe Bashkitë favorizojnë nismën autonome të qytetarëve, individëve dhe të tesseruarve të

formacioneve shoqërore, si p.sh sindikata, shoqata bamirëse etj., për zhvillimin e aktiviteteve me interes të përgjithshëm mbi bazën e parimit të susidiaritetit.

Neni 119

Bashkitë, Provincat, Qytetet Metropolitane dhe Krahinat kanë autonomi financiare hyrjesh të ardhurash e shpenzimi të tyre.

Këto institucione kanë burime të tilla autonome, venë e aplikojnë tribute e taksa në harmoni me Kushtetutën dhe sipas parimeve të koordinimit të financës publike dhe të sistemit tributar. Kanë të drejtë pjesëmarrje në shumën e tributeve e taksave, që janë vjelur nga Shteti në territorin e tyre.

Ligji i Shtetit krijon një fond ndihme për ato territore, që kanë aftësi më të vogla taksavjelëse për çdo banor të tyre. Burimet financiare i bëjnë institucionet vendore e

territoriale të afta për të financuar funksionet e tyre publike që u janë atribuar.

Për të nxitur zhvillimin ekonomik, koezionin e solidaritetin shoqëror, për të hequr ekuilibrat ekonomike, për të favorizuar ushtrimin e të drejtave të individit, Shteti adreson burime shtesë dhe ndërhyjnë në favor të Bashkive, Provincave, Qyteteve Metropolitane dhe Krahinave të caktuara.

Organizmat dhe institucionet vendore kanë pasuri të tyre të atribuar sipas parimeve të përgjithshme të caktuara me ligj Shteti. Mund të futen në borxh vetëm për të financuar shpenzime për investime. Përfshihet çdo garanci e Shtetit në këtë rast.

Neni 120

Krahina nuk mund të vendosë taksa për import ose eksport a për tranzit midis Krahinave. Ajo nuk mund të marrë masa që të pengojnë në çfarëdo

mënyre lëvizjen e lirë të njerëzve dhe të mallrave midis Krahinave. Ajo nuk mund të kufizojë të drejtën e shtetasve për të ushtruar në çfarëdo pjese të territorit kombtar, profesionin dhe punën e tyre.

Qeveria mund të ndërhyjë dhe të zëvendësojë organet e Krahinave, Qyteteve Metropolitane, Provincave dhe Bashkive vetëm në rast mosrespektimi të normave të Bashkimit Evropian ose në rast rreziku të rëndë për sigurinë publike e kur lipset mbrojtja e unitetit juridiko-ekonomik, e në veçanti mbrojtja e niveleve esenciale të shërbimeve, që kanë të bëjnë me të drejtat civile e shoqërore, duke mos marrë parasysh kufijtë territorialë të pushteteve vendore. Ligji përcakton procedurat për të garantuar, që fuqitë e kompetencat zëvendësuese të Shtetit ndaj atyre lokale e rajonale, të ushtrohen duke respektuar parimin e susidiaritetit e atë të bashkëpunimit të drejtë e

të sinqertë midis këtyre institucioneve.

Neni 121

Janë organe të Krahinës: Këshilli krahinor, Junta krahinore dhe Kryetari i saj -Presidenti.

Këshilli krahinor ushtron kompetencat ligjvënëse dhe të nxjerrjes së rregulloreve që i njihen Krahinës, si dhe funksionet e tjera, që i caktohen nga Kushtetuta e nga ligjet. Ai mund t'u propozojë ligje Dhomave të Parlamentit.

Junta krahinore është organi ekzekutiv i Krahinave.

Kryetari i Juntës përfaqëson Krahinën, drejton politikën e Juntës dhe është i përgjegjshëm; shpall ligjet dhe rregulloret krahinore; drejton funksionet administrative, që Shteti i delegon Krahinës, duke ju përmbajtur udhëzimeve të Qeverisë së Republikës - pushtetit qëndror .

Neni 122

Sistemi i zgjedhjeve, numri dhe rastet e pazgjedhshmërisë dhe papajtueshmërisë së Presidentit dhe të këshilltarëve krahinorë caktohen me ligj të Krahinës në limitet e parimeve themelore të përcaktuara nga ligji i Republikës, që përcakton edhe kohëzgjatjen e këtyre organeve të zgjedhura.

Askush nuk mund të marrë pjesë njëkohësisht në një Këshill krahinor o në një Juntë dhe në njërin prej Dhomave të Parlamentit ose në një tjetër Këshill o në një Juntë tjetër krahinore, domethënë në Parlamentin Evropian.

Këshilli zgjedh nga gjiri i tij një Kryetar-President dhe një kryesi për punimet e veta.

Këshilltarët krahinorë nuk kanë përgjegjësi për mendimet e shprehura dhe për votat e dhëna gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre.

Presidenti i Juntës krahinore zgjidhet me mënyrë direkte, përveç rastit kur statuti krahinor përcakton një mënyrë tjetër të zgjedhjes së tij. Presidenti i zgjedhur në këtë mënyrë emëron dhe heq anëtarët e Juntës krahinore.

Neni 123

Çdo Krahinë ka një statut, që në harmoni me Kushtetutën përcakton formën e qeverisjes dhe parimet themelore të organizimit dhe funksionimit të tij. Statuti rregullon ushtrimin e së drejtës së nismës ligjpropozuese dhe të referendumit mbi ligjet dhe masat administrative të Krahinës dhe botimin e ligjeve dhe rregulloreve krahinore.

Statuti aprovohet dhe modifikohet nga Këshilli krahinor me ligj të miratuar nga shumica absolute e anëtarëve të tij, me dy votime të mundshme të

njëpasnjëshme, që kanë midis njëra-tjetrës një interval kohor jo më pak se dy muaj. Për të tilla ligje nuk kërkohet mirëpëlqimi i Komisarit të Qeverisë. Qeveria e Republikës mund të paraqesë çështjen e legjitimitetit kushtetues mbi statutet krahinore para Gjykatës Kushtetuese, brenda tridhjetë ditësh nga botimi i tyre në organet zyrtare të shtypit ligjor. Statuti i nënshtrohet një referendumit aproves popullor, atëherë kur, brenda tre muajsh nga botimi i tyre në organet zyrtare, e kërkon një e pesëdhjeta e zgjedhësve të Krahinës ose një e pesta e anëtarëve të Këshillit Krahinor. Statuti që i nënshtrohet referendumit nuk miratohet përfundimisht, nqs nuk aprovohet nga shumica e votave të vlefshme. Në çdo Krahinë, statuti disiplinon Këshillin e autonomive lokale, si organ këshillimor midis Krahinës

dhe Organizmave vendore, si p.sh Provincat dhe Bashkitë.

Neni 124

është anuluar sipas ligjit kushtetues nr. 3 të datës 18 Tetor 2001

Neni 125

Në Krahinë krijohen organe të drejtësisë administrative të shkallës së parë, sipas organizimit të përcaktuar me ligj të Republikës. Mund të krijohen seksione me seli të ndryshme nga kryeqendra e Krahinës

Neni 126

Me dekret të argumentuar të Presidentit të Republikës mund të vendoset shkrija e Këshillit Krahinor dhe heqja nga posti i Presidentit të Juntës Krahinore, që kanë kryer veprime antikushtetuese ose shkelje të rënda ligji. Shkrija dhe heqja nga posti mund të

bëhen edhe për motive sigurie kombtare. Dekreti vendoset pasi dëgjohej një Komision Deputetësh e Senatorësh i ngritur për çështjet krahinore në mënyrat e caktuara me ligj shtetëror. Këshilli Krahinor mund të shprehë votëmosbesim ndaj Presidentit të Juntës Krahinore nëpërmjet një mocioni të argumentuar, nënshkruar nga të paktën një e pesta e anëtarëve të saj dhe e miratuar me një thirrje nominale të anëtarëve e me mazhorancë absolute. Mocioni nuk mund të hiqet për diskutim para tre ditësh nga prezantimi i tij.

Miratimi i mocionit të mosbesimit ndaj Presidentit të Juntës i zgjedhur direkt, heqja e tij, pengimi fizik permanent, vdekja apo dorëheqja e vullnetshme sjellin si pasojë dorëheqjen konsekuente të Juntës dhe shkriren e Këshillit. Në çdo rast të njëjtat pasoja mund të verifikohen pas

dorëheqjes të shumicës së anëtarëve të Këshillit.

Neni 127

Qeveria, kur e sheh, që një ligj krahinor i tejkalon kompetencat e Krahinës, mund të paraqesë për shqyrtim ligjin krahinor në fjalë para Gjykatës Kushtetuese brenda gjashtëdhjetë ditësh nga botimi i tij në organet zyrtare të shtypit ligjor.

Krahina, kur sheh, që një ligj o një akt me karakter ligj shteti o të një Krahine tjetër, cënon sferën e tij të kompetencave, mund të paraqesë këtë ligj para Gjykatës Kushtetuese për motive legjitimiteti kushtetues brenda gjashtëdhjetë ditësh nga botimi i ligjit o të aktit që ka vlerë ligji në organet zyrtare të shtypit ligjor.

Neni 128

është anuluar sipas ligjit kushtetues nr. 3 të datës 18 Tetor 2001

Neni 129

është anuluar sipas ligjit kushtetues nr. 3 të datës 18 Tetor 2001

Neni 130

është anuluar sipas ligjit kushtetues nr. 3 të datës 18 Tetor 2001

Neni 131

Formohen keto Regjione: piemonti; Val d'Aosta; Lombardia; Trentino-Alto Adixhe; Veneto; Friuli-Venecia Xhulia; Liguria; Emilia-Romanja; Toskana; Umbria; Marke; Lacio; Abruci; Molize; Kampania; Pulja; Bazilikata; Kalabria; Sicilia; Sardenja.

Neni 132

Me ligj kushtetues, pasi dëgjohen Këshillat Krahinore, mund të vendoset shkrirja e Krahinave ekzistuese ose krijimi i Krahinave t'reja me një numër prej të paktën një milion banorësh, kur bëjnë kërkesë të tillë shumë Këshilla Bashkiak që të

përfaqësojnë të paktën një të tretën e popullsisë të interesuara dhe po të jetë miratuar propozimi me referendum nga shumica e vetë popullsisë.

Me aprovimin e mazhorancës të banorëve të interesuar të Provincës o të Provincave të interesuara dhe të Bashkisë o të Bashkive të interesuara shprehur me një referendum e me ligj të Republikës, pasi dëgjohen Këshillat Krahinorë, mund të lejohen që Provincat dhe Bashkitë, të cilat bëjnë një kërkesë të tillë, të shkëputen nga një Krahinë dhe të bashkohen me një tjetër.

Neni 133

Ndryshimi i njesive provinciale dhe krijimi i Provincave të reja në kuadrin Regjion behen me ligje të Republikës, me nisme të Komunave, pasi degjohet vetë Regjioni. Regjioni, pasi degjon

popullsitate e interesuara, mundet me ligje te veta, te trijone ne territorin e tij Komuna te reja dhe te ndryshoje njesite dhe emertimet e tyre.

Kreu VI ***Garanci Kushtetuese***

Seksioni I ***Gjykata kushtetuese***

Neni 134

Gjykata Kushtetuese gjykon:

per mosmarreshjet ne lidhje me kushtetutshmerine e ligjeve dhe te akteve, qe kane vleren e ligjit, te Shtetit dhe te Regjioneve;

per konfliktet e kompetenkave ne mes pushteteve te Shtetit dhe per ato ne mes Shtetit dhe Regjioneve, dhe ne mes Regjioneve;

per akuzat e ngritura kunder Presidentit te Republikes dhe Ministrave, sipas normave te Kushtetutes.

Neni 135

Gjykata Kushtetuese perbehet nga 15 gjyqtare, nje e treta e te cileve emerohen nga Presidenti i Republikes, nje e treta nga Parlamenti ne seance te perbashket dhe nje e treta nga organet e larta te drejtesise te zakonshme dhe administrative.

Gjyqtaret e Gjykates Kushtetuese zgjidhen nder gjyqtaret, edhe pensioniste, te jurisdiksioneve te larta te zakonshme dhe administrative, profesoreve ordinare te universitetit ne lende juridike dhe avokateve pas 20 vjet veprimtarie pratike.

Gjyqtaret e Gjykates Kushtetuese emerohen per 9 vjet, qe fillojne per secilin nga dita e betimit dhe nuk mund te emerohen perseri.

Ne mbarim te afatit merr fund detyra dhe ushtrimi i

funksionit të gjyqtarit kushtetues.

Gjykata zgjedh nga gjiri i anetareve të saj sipas normave të caktuara nga ligji, Kryetarin, që mbetet në fuqi për një trevjeçar dhe mund të rizgjidhet; nga kjo nuk ndryshon gjithsesi afati i vazhdimit të funksionit të gjyqtarit.

Detyra e gjyqtarit kushtetues është e papajtueshme me atë të anetarit të Parlamentit, të një Keshilli regjional, me ushtrimin e profesionit të avokatit dhe me çdo detyrë e funksion me ushtrimin e profesionit të avokatit dhe me çdo detyrë e funksion të percaktuar nga ligji. Në gjykimet e akuzave kundër Presidentit të Republikës dhe kundër Ministrave, marrin pjesë, përveç gjyqtareve të zakonshëm të Gjykatës Kushtetuese, 16 anetare të zgjedhur me short nga një listë shtetasish që i kanë cilesite për t'u zgjedhje me të njëjten mënyrë të caktuar për

emerimin e gjyqtareve ordinare.

Neni 136

Kur Gjykata e cileson si antikushtetues një normë ligjore ose një akt që ka vlerën e ligjit, norma shfuqizohet që nga e nesërmeja e botimit të vendimit.

Vendimi i Gjykatës botohet dhe u njoftohet Dhomes dhe Keshillave regjionale të interesuar, në mënyrë që, po ta quajne të nevojshme, të marrin masa sipas formave kushtetuese.

Neni 137

Një ligj kushtetues percakton kushtet, format, afatet e mundesise se proporzimit të gjkimeve për kushtetueshmeri, dhe garancite e pavaresise se gjyqtareve të Gjyktates se Kushtetuese.

Me ligj të zakonshëm vendosen n ormat e tjera të nevojshme për formimin dhe funksionimin e Gjktates.

Kunder vendimeve te Gjyktates Kushtetuese nuk lejohet asnje ankim.

Seksioni II
Rishikimi i Kushtetutes
Ligjet kushtetuese

Neni 138

Ligjet per rishikim e Kushtetutes dhe ligjet e tjera kushtetuese miratohen nga secila Dhome me dy vendime radhazi me nje interval jo me te vogel se tre muaj, dhe miratohen me shumicen absolute te pjesetareve te seciles Dhome ne votimin e dyte.

Ligjet vete i nenshtrohen referendumit popullor kur, brenda tre muajve nga botimi i tyre. Kete ta kerkojne nje e pesa e anetareve te nje Dhome ose 500.000 zgjedhes ose pese Keshilla regjionale. Ligji qe i shtrohet e vatave te vlefshme.

Nuk zhvillohet referendum ne rast se ligji ne votimin e dyte eshte miratuar nga secila Dhome me nje

shumice dy te tretasg te anetareve te saj.

Neni 139

Forma republikane nuk mund te jete objekt rishikimi kushtetues.

Vendimet tranzitore dhe finale

I

Me hyrjen në fuqi të Kushtetutës, Presidenti provizor i Shtetit ushtron detyrat e Presidentit të Republikës dhe për këtë merr titullin.

II

Nëse në datën e zgjedhjes të Presidentit të Republikës nuk janë krijuar të gjithë Këshillat Krahinorë, marrin pjesë në zgjedhje, vetëm anëtarët e të dyja Dhomave të Parlamentit.

III

Për formimin e parë të Senatit të Republikës janë

emëruar Senatorë, me dekretin e Presidentit të Republikës, deputetët e Asamblesë Kushtetuese, që zotërojnë cilësitë e ligjit për të qënë Senatorë dhe që:

kanë qënë president të Keshillit të Ministrave o të Asambleve legjislative;

që kanë bërë pjesë të Senatit të mëparshëm; që kanë patur të paktën tre zgjedhje, përfshirë dhe atë të Asamblesë Kushtetuese;

që janë deklaruar të hequr nga detyra në mbledhjen e Dhomës së Deputetëve të 09 Nëntorit 1926;

që kanë vuajtur dënimin me burgim jo më pak se pesë vjet sipas dënimit të Gjykatës speciale fashiste për mbrojtjen e Shtetit.

Janë emëruar gjithashtu senatorë, me dekretin e Presidentit të Republikës, anëtarët e Senatit të mëparshëm, që kanë bërë pjesë të Këshillit Nacional.

Në të drejtën për tu emëruar senator mund të hiqet dorë para firmës të dekretit të emërimit. Pranimi i

kandidaturës në zgjedhjet politike detyron-të heq dorë nga e drejta e emërimit si senator.

IV

Për zgjedhjen e parë të Senatit, Molize është konsideruar si Krahinë e veçantë, me numrin e senatorëve që i përket në bazë të popullatës së saj.

V

Disponimi i Nenit 80 të Kushtetutës, për sa i përket vijave internacionale që importojnë detyrime financave apo modifikime të ligjit, ka efekt që nga data e mbledhjes së Dhomave të Parlamentit.

VI

Brenda pesë vjetëve të futjes në fuqi të Kushtetutës vazhdohet me rishikimin e organeve speciale të juridiksionit të tanishëm, me përjashtim të juridiksioneve të Këshillit të Shtetit, të Gjykatës të Kontëve dhe të Gjykatave

ushtarake. Brenda një viti nga e njëjta datë merren masa me ligj për organizimin e Gjykatës supreme ushtarake në bazë të Nenit 111.

VII

Deri kur të jetë emëruar ligji i ri mbi organizimin gjykues konform me Kushtetutën, vendimi i mosmarrëveshjeve të treguara në Nenin 134 zë vend në format dhe kufijtë e normave që ekzistojnë para hyrjes në fuqi të Kushtetutës.(*)

Shënim:

(*) Neni 7 i ligjit kushtetues i 22 Nëntorit 1967, nr .2, ka anuluar paragrafin e fundit të vendimit, që citonte si vijon: “Gjykatësit e Gjykatës kushtetuese të emëruar në përbërjen e parë të Gjykatës nuk janë të nënshtruar në rinovimin parcial dhe rrinë në detyrë dymbëdhjetë vjet” .

VIII

Zgjedhjet e Këshillave krahinore dhe të organeve zgjedhëse të administrimeve provinciale janë të organizuara brenda një viti nga futja në fuqi e Kushtetutës.

Ligjet e Republikës sistemojnë për çdo degë të Administrimit Publik, kalimin e funksioneve shtetërore që i takojnë Krahinave. Deri kur të merren masat për organizimin dhe shpërndarjen e funksioneve administrative midis enteve lokale, i takojnë Provincave dhe Bashkive funksionet që ushtrohen tani dhe të tjerave, që Krahinat i japin autorizimin për ushtrimin e tyre.

Ligjet e Republikës ia dorëzojnë Krahinave kalimin e funksionarëve dhe të vartësve të Shtetit, edhe të administrimeve qendrore, që është i nevojshëm nga ligji i ri. Për formimin e zyrave të tyre, Krahinat, me përjashtim të rasteve të nevojshme, duhet

të nxjerrin personelin e vet nga ai i Shtetit dhe nga entet lokale.

IX

Republika, brenda tre vjetëve të futjes në fuqi të Kushtetutës, përshtat ligjet e saj me kërkesat e autonomive lokale dhe me kompetencën legislative që i takon Krahinave.

X

Krahinës së Friuli-Venecia Xhulias, sipas Nenit 116, i aplikohen përkohësisht normat e përgjithshme të Kreut të V, të pjesës së dytë, pa lëvizur mbrojtjen e pakicës gjuhësore konform me Nenin 6.

XI

Deri në pesë vjet nga futja në fuqi e Kushtetutës, me ligje kushtetuese, mund të formohen Krahina të tjera, me modifikim të listës sipas Nenit 131 edhe pa konkurs të kushteve të kërkuara nga paragrafi i

parë i Nenit 132, pa lëvizur gjithashtu detyrimin për të dëgjuar popujt e interesuar. (*)

Shënim:

(*) Afati i vendimit që citohet në këtë Nen është shtyrë në datën 31 Dhjetor 1963 nga ligji kushtetues i 18 Marsit 1958, nr. 1.

XII

Është i ndaluar riorganizimi i çdo lloj forme i partisë fashiste të mëparshme.

Në normë të Nenit 48, janë përcaktuar me ligj për jo më shumë se pesë vjet nga futja në fuqi e Kushtetutës, kufij të përkohshëm të së drejtës së votës dhe të emërimit për pergjegjësit e regjimit fashist.

XIII

Pjesëtarët dhe pasardhësit e Shtëpisë Savoja nuk janë zgjedhës dhe nuk mund të mbulojnë as zyrat publike as detyrat zgjedhëse. Ish mbretërve

tëShtëpisë Savoja, bashkëshortëve të tyre dhe pasardhësve meshkuj të tyre, i është ndaluar hyrja dhe qëndrimi në territorin nacional. Pasuritë ekzistuese në territorin nacional të ish mbretërve të Shtëpisë Savoja, të bashkëshortëve të tyre dhe të pasardhësve meshkuj të tyre, i detyrohen Shtetit. Trasferimet dhe krijimet e të drejtave reale mbi pasuritë, që janë bërë pas datës 02 Qershor 1946 janë të pavlefshme.(*)

Shënim:

(*) Ligji kushtetues i 23 Tetorit 2002, nr.1 ka vendosur, që paragrafi i parë dhe i dytë i Nenit XIII “vendim kalimtar dhe final” të Kushtetutës i mbarojnë efektet e tyre duke filluar nga data e futjes në fuqi të të njëjtit ligj kushtetues (10 Nëntor 2002).

XIV

Titujt e shtresës fisnike nuk janë të njohur. Kallëzuesit e titujve që

kanë ekzistuar më përpara datës 28 Tetor 1922, vlejnë si pjesë e emrit. Urdhëri i mauricianit është i konservuar si ent spitalor dhe funksionon në mënyrat e përcaktuara nga ligji.

XV

Me hyrjen në fuqi të Kushtetutës është për t’u kthyer në ligj,dekreti legjislativ i 25 Qershorit 1944, nr. 151, mbi urdhërin e përkohshëm të Shtetit.

XVI

Brenda një viti nga futja në fuqi e Kushtetutës vazhdohet me revizionimin dhe me koordinimin e ligjeve kushtetuese të mëparshme, që nuk kanë qënë deri tani të anuluar shprehimisht apo jo shprehimisht.

XVII

Asamblea Kushtetuese do të thëritet nga Presidenti i saj për të vendosur brenda 31 Janarit 1948, mbi ligjin për zgjedhjen e Senatit të

Republikës, mbi statutet krahinore speciale dhe mbi ligjin për shtypin.

Deri në ditën e zgjedhjeve të Dhomave të reja, Asamblea Kushtetuese mund të jetë thirrur kur të ketë nevojë për të vendosur në lëndët që i takojnë kompetencave të saj nga Nenet 2, paragrafi i parë dhe i dytë, dhe 3, paragrafi i parë dhe i dytë, të dekretit legjislativ të 16 Marsit 1946, nr. 98. Në këtë periudhë, Komisionet e përhershme qëndrojnë në funksionim, ndërsa ato legjislative çojnë në Qeveri projektet e ligjit, me rast vërejtje dhe propozime të korigjimeve të projekteve të ligjit.

Deputetët mund t'i bëjnë Qeverisë pyetje me kërkesë dhe përgjigje të shkruajtur. Asamblea Kushtetuese, në efektet e cituara në paragrafin e dytë të këtij Neni, është thirrur nga Presidenti i saj në bazë të një kërkesë të arsyetuar nga ana e Qeverisë ose të

paktën nga ana e dyqind deputetëve.

XVIII

Kushtetuta e tanishme është bërë publike nga Presidenti i përkohshëm i Shtetit brenda pesë ditëve nga aprovimi i tij nga ana e Asamblesë Kushtetuese dhe hyn në fuqi më 01 Janar 1948. Teksti i Kushtetutës është i arkivuar në sallën komunale të secilës Bashki të Republikës për të qënë i ekspozuar gjatë gjithë vitit 1948, me qëllim që çdo qytetar mund ta njohë. Kushtetuta, e pajisur me vulën e Shtetit, do të futet në Mbledhjen zyrtare të ligjeve dhe të dekreteve të Republikës.

Kushtetuta duhet të oservohet besnikërisht si ligj themelues i Republikës nga të gjithë qytetarët dhe organet e Shtetit.

A cura di Teliti Brikena